REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE"
SH.A. SUHAREKË

**RREGULLORJA PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN PËR PËRGJEGJËSIN E TË PUNËSUARVE NÊ NPL "STACIONI I AUTOBUSAVE"SH.A SUHAREKË**

Në bazë të dispozitat të nenit 138 të Ligjit Nr-02/L-123 ,për Shoqëri Tregtare,nenit 20,të Ligjit Nr-04-L-111 ,për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087,për Ndërmarrje Publike,nenin 21 të Rregullorës për përgjegjësinë e të punësuarve në N.p.I "Stacioni i Autobusave"Sh.a ,dhe nenit 1 paragrafi 4 pika (d) e Rregullores së Punës së Bordit të Drejtorëve të N.p.I "Stacioni i Autobusave"Sh ,si dhe propozimeve të Bordit të Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë:25.02.2015 ,Bordi i Drejtorëve":

***Miraton***

**RREGULLOREN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN PËR PËRGJEGJËSIN E TË PUNËSUARVE NÊ NPL "STACIONI I AUTOBUSAVE"SH.A SUHAREKË**

**Neni 1**

**Neni 12 i Rregullores bazike ndryshohet dhe riformohet si në vijim;**

**1.Masat për shkeljet e lehta disiplinore;**

.Komisioni disiplinor pas shqyrtimit të hollësishme të rastit i propozon Organit përkatëse që të aplikojë këto masa:

**a)** paralajmrimi verbal (gojor)
**b)** vërejtje me gojë
**c)** vërejtje me shkrim

**2. Masat për shkeljet e rënda disiplinore;**

**d)** ulja e pozitës,
**e)** ndalimi i 1/3 të pagë për një periudhë deri në 3(tre) muaj
**f)** suspendim i përkohshëm, për një periudhë 1 (një) deri në 6(gjashtë) muaj papagesë,dhe
**g)** ndërprerja e mardhënjes së punës,

**Neni 2.**

**Neni 12 ,paragrafi 2 i Rregullores fshihet shtohet një paragraf i ri 3. me tekstin si në vijim:**

**3.**Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1,pika (a),(b) dhe (c) të këtij neni do të shqiptohen nga ana e Kryeshefit ekzekutiv,pë shkelje e lehta ,ndërsa masat disiplinore nga paragrafi 2 pika (d).(e),(f).dhe(g) të këtij neni shqiptohet nga Komisioni disiplinor.

**Neni 3.**

**Hyrja ne fuqi**

Kjo Rregullore hynë në fuqi 8 (tetë) ditë pas miratimit nga ana **e** nga Bordi i Drejtorëve te ndërmarrjes Publike Lokale“Stacioni i Autobusëve”SH.A në Suharekë,dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e ndërmarrjes Publike Lokale“Stacioni iAutobusëve”SH.A në Suharekë.

KRYESUESI I BORDIT TË DREJTORËVE

____________________________________

/XHELAL ÇELAJ/

**NPL “STACIONI I AUTOBUSËVE”**
**SH.A. SUHAREKË**

# RR E G U LL O R J A PËR ORGANZIMIN E BRENDSHËM TË NPL-së DHE CAKTIMIN E TITUJVE,DETYRAVE DHE KOMPETENCAT E SECILIT ZYRTAR TË NPL-së

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 138 të Ligjit Nr-02/L-123 ,për Shoqëri Tregtare,nenit 20,të Ligjit Nr-04-L-111 ,për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087,për Ndërmarrje Publike,nenin 18 të Rregullorës për organizimin e brendshëm të Npl-së dhe caktimin e titujve ,detyrave dhe kompetencat e secilit zyrtarë të N.p.I “Stacioni i Autobusave”Sh.a ,dhe nenit 1 paragrafi 4 pika (d) e Rregullores së Punës së Bordit të Drejtorëve të N.p.I “Stacioni i Autobusave”Sh ,si dhe propozimeve të Bordit të Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë:06.08.2014 ,Bordi i Drejtorëve unanimisht mori këtë:

***Miraton***

**RR E G U LL O R J A PËR ORGANZIMIN E BRENDSHËM TË NPL-së DHE CAKTIMIN E TITUJVE,DETYRAVE DHE KOMPETENCAT E SECILIT ZYRTAR TË NPL-së**

**Neni 1.**

**Neni 15 ,pika (f) i Rregullores bazike ndryshohet dhe riformohet si në vijim;**

Vendi i punës shërbim i mirëmbajtjes ,përgaditja fillore,1(një) vit përvojë pune,shkathtësi në punë.

**Neni 2.**

**Hyrja ne fuqi**

Kjo Rregullore hynë në fuqi 8 (tetë) ditë pas miratimit nga ana **e** nga Bordi i Drejtorëve te ndërmarrjes Publike Lokale“Stacioni i Autobusëve”SH.A në Suharekë,dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e ndërmarrjes Publike Lokale“Stacioni iAutobusëve”SH.A në Suharekë.

.

KRYESUESI I BORDIT TË DREJTORËVE

________________________________

/XHELAL ÇELAJ/